

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6842  
E martë, 7 mars 2023  
çmimi 0.40 €

Nik Gjeloshaj rizgjedhet kryetar i Tuzit | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

PUSHTETI DHE OPOZITA KUJTOJNË SAKRIFICËN  
E FAMILJES JASHARI DHE LUFTËN E UÇK-së | FAQE 4-5

## MESAZHI I RIFAT JASHARIT PËR POZITËN DHE OPOZITËN: TË JENI TË NJË GJUHE



Kuvendi i Kosovës të hënën, me rastin e 25-vjetorit të "Epopesë së UÇK"-së, ka mbajtur një seancë solemne. Pozita dhe opozita kanë vlerësuar lart kontributin e familjes Jashari dhe të komandantit legjendar Adem Jashari për liri dhe pavarësi. Në këtë seancë, në të cilën ka qenë i pranishëm edhe

përfaqësuesi i familjes Jashari, Rifat Jashari, ka bërë thirrje për unitet në përballje me Serbinë. Duke vlerësuar kontributin e dëshmorëve, martirëve, veteranëve të UÇK-së dhe invalidëve të luftës, baca Rifat ka kërkuar nga pushteti dhe opozita të jenë të një gjuhe në ballafaqimin me Serbinë.

"Këtu është Kuvendi. Këtu merren vendimet për të ardhmen e vendit. Ju kisha sugjeruar të jeni të një gjuhe dhe të një qëndrimi, dhe ta kalojmë këtë sfidë që e kemi përpara. Të ndahemi një herë e përgjithmonë nga Serbia e pastaj kemi kohë të merremi me të tjerat", ka thënë baca Rifat f

A DO TA NËNSHKRUAJNË KOSOVA DHE SERBIA MË NË FUND NJË MARRËVESHJE? | FAQE 7



PSD-ja SHTRON PARA QEVERISË 205 MIJË NËNSHKRIMET KUNDËR ASOCIACIONIT | FAQE 7



### AKTUALE



TRUPI GJYKUES FTON ZPS-në T'I NGUSHTOJË AKUZAT NË RASTIN E LIDERËVE TË UÇK-së | F. 3

AMBASADORI HILL: FORMIMI I ASOCIACIONIT, TEST PËR KOSOVËN | F. 7

KMDLNJ-ja: QYTETARËT NË MËNYRË TË ORGANIZUAR TA KUNDËRSHTOJNË SHTRENTJIMIN E RRYMËS | F. 6

KOMUNA E PRISHTINËS I OBLIGON LOKALET TË PAJISEN ME MATËS TË ZHURMËS | F. 6

### EKONOMI



NGA 2 MARS KOSOVA NUK ËSHTË DUKE MARRË ENERGJI ELEKTRIKE NGA SHQIPËRIA | F. 8

### SPORT



KOK-U RRIËT PËR 2 880 EURO NË MUJ VLERËN E BURSIVE OLIMPIKE 'PARIS 2024' | F. 10

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjbiznesi.com](http://www.kolegjbiznesi.com)  
info@kolegjbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVE  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Shefi i Pentagonit: Bakhmuti ka më shumë vlerë simbolike sesa strategjike

WASHINGTON, 6 MARS - Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Lloyd Austin, tha të hënën se nëse trupat ruse arrijnë ta marrin kontrollin e qytetit lindor të Ukrainës, Bakhmutit, kjo gjë nuk do të sillte një ndryshim vendimtar në konflikt. "Mendoj se ka më shumë vlerë simbolike sesa vlerë strategjike dhe operacionale", u ka thënë sekretari Austin gazetarëve gjatë një vizite në Jordani. Prej muajsh, Bakhmuti është përfshirë në luftime intensive mes përpjekjeve të Rusisë për ta marrë kontrollin e këtij qyteti,

që shtrihet në provincën Donetsk të Ukrainës. Gjithashtu, Austini ka thënë se një vendim i forcave ukrainase për t'i dislokuar trupat në perëndim të qytetit nuk do të përbënte, sipas tij, një problem strategjik për Kievin. Por, ushtria e Ukrainës ka njoftuar të hënën për një raund të ri sulmesh ruse gjatë të cilave u përdorën dronë të prodhuar nga Irani. Në një njoftim në "Twitter", Ministria ukrainase e Mbrojtjes ka shkruar se forcat e saj kishin arritur të rrëzonin 13 prej 15 dronëve të lëshuar.

Moska ka përdorur dronë "Shahed" për të goditur objektivë në të gjithë Ukrainën, përfshirë objekte infrastrukturore. Po kështu Rusia ka njoftuar se ministri i Mbrojtjes, Sergei Shoigu, ka vizituar të hënën ushtarët rusë si dhe një qendër mjekësore në qytetin e Mariupolit, të cilin Rusia e ka rrafshuar vitin e kaluar. Sipas Ministrisë së Mbrojtjes, Shoigu ka vizituar qytetin me qëllimin për ta mbikëqyruar përpjekjet për rindërtimin e tij, por pa dhënë detaje se kur u zhvillua vizita.



## Kryeministri letonez, pro dërgimit të avionëve luftarakë në Ukrainë

RIGA, 6 MARS - Kryeministri i Letonisë, Krisjanis Karins, tha se është në favor të furnizimit të Ukrainës me avionë luftarakë. Kështu i ka thënë ai gazetës gjermane "Der Spiegel", duke shtuar se "nuk e di pse vendet perëndimore nuk duhet t'i dorëzojnë Ukrainës avionë luftarakë". "Nëse ukrainasit kanë nevojë për avionë luftarakë, duhet t'i marrin ata", ka thënë ai. Sipas tij, "dorëzimi i avionëve luftarakë është vetëm çështje kohe".

Gjatë vizitës së tij në Parlamentin britanik më 8 janar, presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky u ka bërë



thirrje në mënyrë specifike liderëve perëndimorë që të siguronin avionë luftarakë. "Unë ju bëj thirrje juve dhe botës, me fjalët e thjeshta por të rëndësishme - avionë luftarakë për Ukrainën, krahe për lirinë", ka thënë ai. Por, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Gjermania janë shprehur kundër kësaj kërkesë. Kancelari gjerman Olaf Scholz ka thënë se Gjermania nuk do të dërgojë avionë luftarakë në Ukrainë. Gjithashtu, presidenti amerikan Joe Biden ka thënë se ShBA-ja nuk do të dërgojë avionë luftarakë F-16 në Ukrainë. Por, presidenti francez

Emmanuel Macron ka thënë se Franca nuk e përjashton dërgimin e tyre nëse plotësohen disa kushte. Në janar Gjermania u pajtua për të dërguar tanke Leopard 2 në Ukrainë dhe për t'i lejuar vendet e tjera evropiane të dërgonin të tyre, pas disa javësh debat intensiv dhe presion në rritje nga aleatët. Ukraina ka muaj që kërkon tanke luftarake për t'i luftuar forcat ruse që e kanë nisur luftën në këtë shtet. Polonia, Spanja, Finlanda, Holanda dhe Norvegjia dhe disa shtete të tjera pritjet që këtë muaj t'i dërgojnë tanket e tyre Leopard në Ukrainë.

## Gjykata në Minsk dënon me 15 vjet burgim lideren opozitare

MINSK, 6 MARS - Një gjykatë në Minsk ka dënuar në mungesë me burgime të gjata lideren opozitare në mërgim, Svyatlana Tsikhanouskaya, dhe katër liderë të tjerë opozitarë, për akuzat që gjerësisht konsiderohen se janë të motivuara politikisht. Gjykata e Qytetit të Minskut më 6 mars ka dënuar Tsikhanouskayan me 15 vjet burgim, ndërkaq politikanin tjetër opozitar, Pavel Latushka, me 18 vjet.

Tri figurat e tjera opozitare, Maryya Maroz, Volha Kavalkova, dhe Syarhey Dylevski, u dënuan me nga 12 vjet burgim.

Gjykatësi Pyatro Arlou ka shpallur pesë politikanët opozitarë fajtorë për tentim të rrëzimit të qeverisë, krijim dhe udhëheqje të grupit ekstremist, nxitje të urrejtjes dhe dëmtim të sigurisë kombëtare. Të pesë figurat opozitare janë

larguar nga Bjellorusia në fillim të protestave masive vdekjeprurëse, që u mbajtën për ta kundërshtuar rezultatin zyrtar të zgjedhjeve presidenciale të gushtit të vitit 2020. Këto zgjedhje udhëheqësi autoritar Alyksandr Lukashenka pretendon se i ka fituar. Opozita bjelloruse dhe qeveritë perëndimore thonë se zgjedhjet u manipuluan dhe fituesja e vërtetë e zgjedhjeve është Tsikhanouskaya.

Tsikhanouskaya ka thënë se gjykimi ndaj saj ishte "farsë" dhe "hakmarrje" nga Lukashenka dhe shtoi se nuk i është dhënë qasje në dokumentet e gjykatës. "Kështu regjimi 'shpërbleu' punën time për ndryshime demokratike në Bjellorusi. Por, sot nuk mendoj për dënimin tim. Mendoj për mijëra të pafajshëm, të arrestuar dhe dënuar me dënime të vërteta me burg", ka

shkruar ajo në "Twitter". Shqiptimi i dënimeve është bërë me dije disa ditë pasi një gjykatë në Bjellorusi ka zgatur dënimin me burgim për 18 muaj ndaj burrit të Tsikhanouskayas, Syarhey Tsikhanouski, për shkak të, siç është thënë, "shkeljes" së rregulloreve të brendshme në paraburgim. Tsikhanouski është duke kryer 18 vjet burgim për akuzat që lidhen me zgjedhjet e vitit 2020. Ai kishte njoftuar për pjesëmarrjen në zgjedhjet presidenciale duke sfiduar Lukashenkën, por u diskualifikua nga gara dhe u arrestua para mbajtjes së zgjedhjeve. Më pas, gruaja e tij nisi fushatën për t'u bërë presidente. Mijëra persona janë arrestuar në protestat kundër rezulttit zgjedhor dhe ka pasur raporte të besueshme se të arrestuarit janë keqtrajtuar dhe torturuar nga



forcat e sigurisë. Disa persona kanë vdekur gjatë shtypjes së protestave. Lukashenka, 68 vjeç, varet shumë nga mbështetja ruse teksa përballlet me sanksione

perëndimore. Shtetet e Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe disa shtete të tjera refuzojnë ta pranojnë fitoren e vetëshpallur të Lukashenkës në zgjedhjet e vitit 2020.

# Trupi gjykues fton ZPS-në t'i ngushtojë akuzat në rastin e liderëve të UÇK-së

HAGË, 6 MARS - Në vendimin e marrë lidhur me kërkesën e mbrojtjes së ish-presidentit Hashim Thaçi, ku është kërkuar që trupi gjykues ta ftojë Zyrën e Prokurorit të Specializuar (ZPS) që ta ngushtojë shtrirjen kohore të aktakuzës, në jo më vonë se 20 qershori i vitit 1999, trupi gjykues ka thënë se kohët e fundit e ka ftuar ZPS-në t'i ngushtojë akuzat në aktakuzë në përputhje me rregullën 118(1)(b). Prandaj, në vendimin e trupit gjykues të Gjykatës Speciale është thënë se Paneli e konsideron kërkesën e parë të diskutueshme. Ftesën që prokuroria t'i ngushtojë akuzat në aktakuzë, është thënë se trupi gjykues i Speciales e ka bërë në konferencën e 15 shkurtit.

Më tutje në vendim është thënë se asnjë nga bazat ligjore të avancuara nga mbrojtja dhe/ose e disponueshme sipas rregullave nuk do të zbatohet këtu për ta dhënë lehtësimin e kërkuar.

Për më tepër, trupi gjykues ka rikujtuar se në vendimin e parë konfirmues, gjyqtari i procedurës paraprake, pasi kishte shqyrtuar materialet përkatëse mbështetëse, konstatoi se ZPS-ja kishte krijuar dyshime të bazuara se i akuzuari kishte kryer ose marrë pjesë në kryerjen e krimeve të luftës dhe krimet kundër njerëzimit nga të paktën marsi 1998 deri në shtator 1999.

"Duke kujtuar se e drejta ndërkombëtare humanitare zbatohet përtej ndërprerjes së armiqësive, derisa të arrihet një



mungesë e qëndrueshme e konfrontimeve të armatosura, gjyqtari i procedurës paraprake konstatoi më tej se ekziston një dyshim i bazuar mirë se, të paktën nga marsi 1998 deri më afërsisht më 16 shtator 1999, një jo - konflikti i armatosur ndërkombëtar ka ekzistuar në Kosovë në kuptim të nenit 14(2) ndërmjet forcave serbe dhe UÇK-së", është thënë në vendim.

Gjithashtu në vendim është thënë se gjyqtari i procedurës paraprake ka konstatuar se ekziston një dyshim i bazuar se, së paku nga

marsi 1998 deri në shtator 1999, ka pasur një sulm të gjerë ose sistematik kundër një popullsie civile në Kosovë dhe Shqipërinë veriore në kuptim të nenit 13.39. Në vendimin e dytë konfirmues, gjyqtari i procedurës paraprake ka rikujtuar këto gjetje dhe ka hedhur poshtë argumentet e mbrojtjes së Veselit lidhur me ekzistimin e një konflikti të armatosur, duke konsideruar se ato përbënin një përpjekje për ta anashkaluar kornizën ligjore të Dhomave të Specializuara të Kosovës (DhSK). "Edhe duke supozuar se kuadri

ligjor i DhSK-së ofronte një rrugë procedurale për të rishqyrtuar këto çështje në fazën aktuale të procedurës, provat relevante për pretendimet e mësipërme ende nuk janë vendosur para Panelit. Në lidhje me këtë, Paneli thekson se: (i) çështja (ligjore) nëse ka ekzistuar apo jo një konflikt i armatosur në Kosovë pas datës 20 qershor 1999 (dhe së paku deri në shtator 1999) varet nga gjetjet faktike; dhe (ii) gjetjet e tilla mund të bëhen nga Paneli vetëm pasi të ketë ekzaminuar siç duhet të gjitha provat e ofruara gjatë

gjykimin. Për më tepër, Paneli vëren se: (i) në pajtim me nenin 7, krimet e kryera pas qershorit 1999 ende bien nën juridiksionin e kohor të DhSK-së; dhe (ii) nëse vërtetohet, mund të përbëjnë krimet kundër njerëzimit", është thënë në vendimin e trupit gjykues.

Sipas vendimit, në dritën e sa më sipër, Kolegji nuk është i bindur se e drejta e të akuzuarit për një gjykim të drejtë dhe të shpejtë do të kërkonte një ngushtim të akuzave, ose se kjo e drejtë do të shkelej nëse akuzat nuk ngushtohen në këtë fazë. Në lidhje me këtë, Paneli është thënë se ka rikujtuar se pasi të mbyllet rasti i ZPS-së, mbrojtja, nëse dëshiron, mund të paraqesë një mocion për të hedhur poshtë një ose të gjitha akuzat në aktakuzë në përputhje me Rregullën 130.

"Duke pasur parasysh sa më sipër, Paneli konstaton se Kërkesa e Dytë dhe e Tretë janë të parakohshme (në lidhje me mbështetjen e Mbrojtjes së Thaçit në Rregullën 130) dhe përndryshe pa baza ligjore të vlefshme (në të gjitha aspektet e tjera) në këtë fazë të procedurës", është thënë në vendim.

Ndryshe, Zyra e Prokurorit të Specializuar më 30 shtator 2022 ka dorëzuar aktakuzën e konfirmuar të ndryshuar ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, e cila përbëhet nga dhjetë pika me akuzë, ku këta të fundit ngarkohen për krimet e luftës. /Betimipërdrejtësi/

## Nik Gjeloshaj rizgjedhet kryetar i Tuzit

TUZ, 6 MARS - Koalicioni "Forumi Shqiptar - Bashkim dhe Zhvillim", i drejtuar nga Nik Gjeloshaj, ka fituar shumicën absolute në zgjedhjet në Tuz - komunë e banuar me shumicë shqiptare në afërsi të Podgoricës, të cilat janë mbajtur më 5 mars. Ky koalicion ka marrë rreth 52 për qind të votave. Me këtë rast, Gjeloshaj ka falënderuar qytetarët e kësaj komune, veçanërisht diasporën për besimin e dhënë në zgjedhjet e 5 marsit. "Fjalët nuk mjaftojnë për të përshkruar kontributin e vëllezërve tanë nga diaspora dhe gjithçka që kanë bërë që atdheu i tyre të mbetet në duart e duhura, në duart në të cilat Malësia do të vazhdojë me projekte kapitale dhe zhvillimore", ka shkruar Gjeloshaj në "Facebook".

Ai ka thënë se do të vazhdojnë me punë të mira për qytetarët e Tuzit, pa dallim përkatësi. "Së bashku, ne dëshmuam se disa individë nuk mund t'i përcajnë vëllezërit përmes ndarjeve artificiale, ne dëshmuam se Malësia është e bashkuar dhe e zhvilluar. Më imponon shumë fakti që kemi fituar një numër të madh të votave në vendvotimet

ku ndodhen qytetarët tanë të kombësive që nuk janë shqiptar, ku kjo dëshmon se të gjithë qytetarët kanë parë rezultatet e punës, programit dhe strategjisë sonë zhvillimore. Forumi shqiptar është një koalicion i të gjithë shqiptarëve dhe shqiptarët janë Zot shtëpie të vendit të vetë dhe ne kemi një traditë mijëvjeçare të harmonisë dhe bashkëjetesës multietnike me të gjithë dhe do të vazhdojmë ta bëjmë këtë edhe në të ardhmen, përmes mundësisë të barabarta për gjithë qytetarët tanë", ka shkruar Gjeloshaj.

Në koalicionin "Forumi Shqiptar", përveç partisë së Gjeloshajt - Alternativa Shqiptare (AA), bëjnë pjesë edhe partitë e tjera shqiptare: Aleanca Demokratike e Shqiptarëve (DSh), Unioni Kombëtar Shqiptar (UKSh) dhe Aleanca Demokratike e Malit të Zi (DSCG).

Koalicioni "Rrugës së drejtë" - Partia Demokratike e Socialistëve (DPS), Unioni Demokratik i Shqiptarëve (UDSh), Partia Boshnjake (BS) dhe Social Demokratët (SD), ka fituar 33 për qind të votave.



Në garë ishin edhe dy koalicione të tjera, sikurse koalicioni shqiptar "Bashkë" - Partia Demokratike (PD) dhe Forca dhe koalicioni "Me gjithë zemër për Tuzin" - Partia Socialdemokrate (SDP) dhe Lëvizja për Tuzin si dhe tri subjekte politike: "Më të fortë jemi së bashku" - Demokratët, "Për Tuzin me nderë" - Partia Popullore Socialiste (SNP) dhe "Për gjeneratat e ardhshme" -

Partia për Drejtësi dhe Pajtim (SPP).

Të drejtë vote në këto zgjedhje kishin 12 387 votues, kurse 66.5 për qind kanë marrë pjesë në votime.

Dita e zgjedhjeve ishte e qetë, me parregullsi të vogla që nuk mund të ndikojnë në rezultatin e zgjedhjeve.

Tuzi është në qendër të Malsisë, që gjendet mes Malit të Zi dhe

Shqipërisë. Statusin si komunë e pavarur Tuzi e rifitoi në shtator të vitit 2018, duke u ndarë nga kryeqyteti i Malit të Zi. Dekada më parë Tuzi ishte pjesë administrative e Podgoricës dhe më pas një prej komunave të kryeqytetit. Në zgjedhjet e para të mbajtura më 2019, Partia Demokratike e Socialistëve (DPS) e presidentit Millo Gjukanoviç kishte fituar pushtetin në Tuz.



PUSHTETI DHE OPOZITA KUJTOJNË SAKRIFICËN E FAMILJES JASHARI DHE LUFTËN E UÇK-SË

## Mesazhi i Rifat Jasharit për pozitën dhe opozitën: Të jeni të një gjuhe

Kuvendi i Kosovës të hënën, me rastin e 25-vjetorit të “Epopesë së UÇK”-së, ka mbajtur një seancë solemne. Pozita dhe opozita kanë vlerësuar lart kontributin e familjes Jashari dhe të komandantit legjendar Adem Jashari për liri dhe pavarësi. Në këtë seancë, në të cilën ka qenë i pranishëm edhe përfaqësuesi i familjes Jashari, Rifat Jashari, ka bërë thirrje për unitet në përballje me Serbinë. Duke vlerësuar kontributin e dëshmorëve, martirëve, veteranëve të UÇK-së dhe invalidëve të luftës, baca Rifat ka kërkuar nga pushteti dhe opozita të jenë të një gjuhe në ballafaqimin me Serbinë. “Këtu është Kuvendi. Këtu merren vendimet për të ardhmen e vendit. Ju kisha sugjeruar të jeni të një gjuhe dhe të një qëndrimi, dhe ta kalojmë këtë sfidë që e kemi përpara. Të ndahemi një herë e përgjithmonë nga Serbia e pastaj kemi kohë të merremi me të tjerat”, ka thënë baca Rifat

### Rifat Jashari, deputetëve: Të jeni të një gjuhe, të ndahemi një herë e përgjithmonë nga Serbia

Në seancën solemne kushtuar 25-vjetorit të “Epopesë së UÇK-së ka marrë pjesë edhe përfaqësuesi i familjes Jashari, baca Rifat Jashari. Fillimisht baca Rifat i ka falënderuar miqtë ndërkombëtarë në krye me ShBA-në për ndihmën që ia kanë dhënë Kosovës në kohët më të vështira. Më tutje, baca Rifat Jashari ka kërkuar unitet nga deputetët e Kuvendit të Kosovës në përballje me Serbinë. Ai ka thënë se të gjitha partitë politike në Kuvend duhet të jetë bashkë në mënyrë që Kosova të ndahet përgjithmonë nga Serbia. “Duke falënderuar ShBA-në, bijat

dhe bijtë tanë, ne sot kemi arritur këtu, jemi të lirë që t’i qajmë hallet me njëri-tjetrin. ShBA-ja dhe shtetet mike i kemi prapë para nesh. I falënderoj nënat e dëshmorëve, veteranët, invalidët dhe të gjithë juve. Lavdi e nder të gjithë atyre që kanë rënë! Këtu është Kuvendi. Këtu merren vendimet për të ardhmen e vendit. Ju kisha sugjeruar që të jeni të një gjuhe dhe të një qëndrimi, dhe ta kalojmë këtë sfidë që e kemi përpara. Të ndahemi një herë e përgjithmonë nga Serbia e pastaj kemi kohë të merremi me të tjerat”, ka thënë baca Rifat.

**EPOKA E RE**

**Lirim GEÇI**

**PRISHINË, 6 MARS** - Në ditën e dytë të manifestimit tradicional “Epojeja e UÇK”-së janë mbajtur një numër aktivitete në nderim të të rënëve më 5, 6 dhe 7 mars të vitit 1998 në Prekaz të Skenderajt. Fillimisht liderët e institucioneve dhe ata politikë kanë bërë homazhe në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” me rastin e 25-vjetorit të flijimit të familjes Jashari për liri. Pas homazheve, Kuvendi i Kosovës ka mbajtur një seancë solemne në të cilën është vlerësuar lart figura e komandantit legjendar Adem Jashari dhe familjes së tij. Në këtë seancë ka marrë pjesë edhe përfaqësuesi i familjes Jashari, baca Rifat Jashari dhe anëtarë të tjerë të kësaj familje emblematike. Presidentja Vjosa Osmani para deputetëve të Kuvendit ka thënë se “Epojeja e UÇK”-së është epike e

dinjitetit, krenarisë dhe lirisë. “Nuk thuhet kot se popujt, të cilët e harrojnë historinë e tyre, rrezikojnë përsëritjen e saj. Prandaj ne duhet dhe do ta mbajmë të gjallë kujtesën për sakrificën e familjes Jashari dhe për gjithë luftën e UÇK-së të cilën ata e bënë për vendin”, ka thënë

Osmani. Shefja e shtetit ka thënë se ngjarjet e 5, 6 dhe 7 marsit të vitit 1998 përbëjnë “jo vetëm kujtesën tonë për historinë më të re të Kosovës, por edhe një rëndësi të shtyllat më të forta mbi të cilat u ngrit shteti ynë i ri”. “Kushtrimi i dhënë më 5 mars





nga komandanti Adem Jashari bashkë me familjen e tij ishte kushtrim i mobilizimit të vajzave dhe djemve të UÇK-së të cilët përgjatë tri ditëve të betejës në Prekaz, në një përballje heroike me forcat e regjimit gjenocidal të Serbisë, fituan përjetësinë”, është shprehur Osmani, duke shtuar se familja Jashari dhe luftëtarët e lirisë i kanë dalë zot atdheut në kohët më të vështira. “U jemi mirënjohës përjetësisht të gjithë burrave dhe grave të UÇK-së të cilët i dolën zot atdheut e ranë për lirinë e tij, duke u shndërruar në pjesën më të lavdishme të historisë sonë. Ata dëshmuar se përballë dhunës së skajshme, gjithmonë forcohet skajshmërisht ndjenja për lirinë; përballë synimit për ta shfarosur apo dëbuar një popull të tërë, bëhet e pamposhtur bindja e tij për të jetuar i lirë”, ka thënë Osmani.

### Konjufca: Lufta e familjes Jashari, e pashembullt edhe në historinë botërore

Më tuje, kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, ka thënë se lufta e familjes Jashari ishte ngjarje e pashembullt jo vetëm në historinë e Kosovës, por edhe në historinë botërore. “Familja e gjerë Jashari, tre breza në kullën e tyre shekullore, në tokën e lashtë të stërgjyshërve, nga baci Shaban e deri te Blerimi i vogël, e shpallën lirinë e popullit tonë dhe e mbrojtën atë deri në vetëflimin e tyre të plotë. Lufta ishte aq legjendare, sakrificë aq sublime, kurse vetëmohimi aq tronditës, saqë kombi shqiptar kaloi në një dimension tjetër të vetëdijes, kurse bota u zhvendos nga orbita e vet politike. Ky është momenti kur Ushtria Çlirimtare e Kosovës u bë frymë dhe e përfshiu të gjithë popullin tonë. 5, 6 dhe 7 marsi i vitit 1998 është kthesa kur sakrifica bëhet epepe”, ka thënë Konjufca, duke shtuar se Kosova ka dhënë shumë për liri. “Por lufta e Prekazit dhe rënia e Jasharëve është kondensimi i të gjitha përpjekjeve tona të pareshtura. Ajo e përmban të gjithë mundin, vetëdijen kombëtare dhe gatishmërinë e të gjitha gjeneratave të mëparshme për liri. Thuajse të gjitha ëndrrat e idealet tona qysh nga koha e Skënderbeut, të gjitha burgosjet, sakrificat, vuajtjet e vështirësitë nëpër të cilat kaluam, e pritën Adem e Hamëz Jasharin me prindërit, gratë, fëmijët dhe familjarët e tyre që ta kurorëzonin lirinë tonë”, ka thënë Konjufca. Ai ka thënë se Kosova është mbrojtur me gjak në ata metra katorë të kullës së Jasharëve. “12 qershori dhe 17 shkurti janë kapituj të po atij libri monumental. E të gjithë e dimë që, kur flasim për Jasharët, lavdia e të gjallëve është jo më e paktë se e të rënëve. Besarta mbijetoi për ta ndarë me ne

qëndresën legjendare dhe fljimin e familjes së saj. Zoti u kujdes që dëshmia të jetojë. Shpesh më del para syve momenti kur Baci Rifat kthehet në Prekaz mes varreve ende të freskëta. Me plis në kokë dhe mustaqet e tij të bardha, në atë ecje titanike ai bartte mbi supet e tij si kreshtat e maleve tona krejt dhimbjen tonë historike, por edhe krenarinë tonë më të lartë. I kishte humbur 55 anëtarë të familjes, prej tyre gruan dhe 4 fëmijët e tij, prindërit e tij, vëllezërit bashkë me gratë e tyre dhe 9 nipa e mbesa. Por ishte ai që i ngushëllonte të tjerët, familjarët e gjallë, ushtarët e UÇK-së dhe bashkëfshatarët e tij. Të dashur vëllezër e motra, vetëm për një minutë mundohuni, ju lutem, ta zini vendin e Bacit Rifat, dhe më thoni – a nuk është pikërisht ky definicioni i heroit tonë të gjallë”, ka thënë Konjufca.

### Kurti: Rezistenca e familjes Jashari nuk është një degë në historinë e Kosovës, por vetë trunq

Ndërsa kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se rezistenca e familjes Jashari në Prekaz “nuk është edhe një degë më shumë në pemën e historisë moderne të Kosovës, por është vetë trunq i kësaj peme”. Ai ka thënë se në historinë e UÇK-së dhe të vet shtetit, rezistenca e familjes Jashari dhe figura e Adem Jasharit janë themeltare e “të tilla do të mbeten përjetë”. “Pas 5, 6 dhe 7 marsit 1998 Ushtria Çlirimtare e Kosovës do të rritej si një ushtri vullnetarësh, në të cilën do të mobilizoheshin të gjithë ata që kishin vullnetin dhe guximin për të luftuar për çlirimin e Kosovës. Hamza dhe Ademi do të binin dëshmorë në luftën për lirinë e Kosovës në mars 1998, ndërkaq vëllait më të madh, Rifatit, do t'i takonte ta vazhdonte rrugën e përbashkët të tyre, por edhe me një detyrë shtesë. Që nga marsi i vitit 1998 ky njeri do ta kryente detyrën e vështirë të ruajtjes së trashëgimisë me aq shumë vlera kombëtare dhe peshë historike të familjes Jashari”, është shprehur Kurti.



### Krasniqi: Pa Adem Jasharin dhe shokët e tij në Hagë nuk do të kishte Kosovë të lirë dhe të pavarur

Në këtë seancë solemne, nga një fjalë rasti kanë mbajtur edhe drejtuesit e opozitës. Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka thënë se

nuk ka luftuar vetëm për pragun e shtëpisë. “Ka luftuar për kauzën tonë kombëtare shekullore. Ka luftuar për drejtësinë historike. Dhe madhështia e UÇK-së nuk e merr kuptimin e plotë pa sakrificën e komandantit legjendar Adem Jashari dhe të familjes Jashari, që frymëzoi dhjetëra e mijëra djem e vajza për t’iu përgjigjur kushtrimit për çlirimin e vendit”, ka thënë Krasniqi.



### Presidentja Osmani ia jep Rifat Jasharit “Urdhrin e Lirisë”

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ia ka dhënë “Urdhrin e Lirisë” përfaqësuesit të familjes Jashari, Rifat Jashari. Osmani këtë nderim e ka bërë gjatë vizitës së saj në shtëpinë e familjes Jashari në Prekaz. Osmani bashkë me kryetarin e Kuvendit, Glauk Konjufca, dhe kryeministrin Albin Kurti, kanë bërë homazhe në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz në shënimin e 25-vjetorit të Epopesë së UÇK-së.

Epopeja e UÇK-së përfaqëson një epokë që i bën bashkë të gjitha ngjarjet e luftës për kauzën kombëtare. “Pa Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës nuk do të kishte pasur kurrë një Kosovë të lirë e të pavarur. Pa Adem Jasharin dhe marsin e lavdishëm të '98-s, vështirë se do të kishte pasur një Ushtri Çlirimtare. Prandaj, vlera e kësaj epopeje nuk mund të kuptohet si një ngjarje në kuadrin e historisë, por si një epokë që i bën bashkë të gjitha ngjarjet”, ka thënë ai, duke shtuar se UÇK-ja e ka mbrojtur pragun e shtëpisë, por

Në këtë seancë solemne Krasniqi nuk ka harruar t’i përmendë edhe shokët dhe bashkëluftëtarët e Adem Jasharit të cilët gjenden në paraburgim në Hagë. “Me këtë rast, në këtë ditë të lavdisë shembullore, na mungojnë bashkërrugëtuesit e Adem Jasharit, që nuk iu ndanë rrugës së tij deri në bërjen e Kosovës shtet i lirë e i pavarur, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi e Rexhep Selimi, dhe bashkëluftëtarët e tyre, që të privuar nga liria, po mbahen larg nesh në betejën e fundit për të vërtetën e luftës së drejtë të UÇK-së”, ka thënë Krasniqi.

### Abdixhiku: Qendra e familjes Jashari ishte rilindja jonë kombëtare

Kurse kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka thënë se në historinë e popullit të Kosovës nuk ka asnjë ngjarje tjetër “që arrin të ofrojë dhembshurinë dhe krenarinë në të njëjtën kohë”. “Qëllimi i shuarjes së trugut tuaj familjar, një çerek shekulli më parë, ishte qëllim i shuarjes së popullit shqiptar në Kosovë. Qëndresa juaj atëherë ishte rilindja e jona kombëtare. Rilindja juaj sot si familje, me breza të rinj e pasardhës të Jasharëve, është qëndresë e jona që na mban në rrugën përpara”, ka thënë ai, duke shtuar se familja Jashari është themeli i Republikës së Kosovës. “25 vjet më parë, mes thirrjeve monumentale të brezave nëpër histori, me familjen Jashari dhe 56 anëtarë të familjes, të afërm e bashkëluftëtarë, ranë në altarin e lirisë. Në historinë e popullit të Kosovës nuk ka asnjë ngjarje tjetër që arrin të evokojë dhembshuri dhe krenari në të njëjtën kohë. Kjo thirrje e tyre (familjes Jashari) u dëgjua gjithandej Kosovës. Komandanti i rënë i tyre kishte lënë ndjekës që do të ndërtonin historitë më të bukura të luftës sonë. Sepse Adem Jashari, familja e tij, siç do të thoshte presidenti Rugova, po e mbronte pragun e shtëpisë”, ka thënë ai.

Në këtë seancë një fjalë rasti ka mbajtur edhe deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje dhe bashkëshortja e Rexhep Selimit, Shqipe Selimi. Ajo ka thënë se “Epopeja e UÇK”-së në historinë e luftërave të shqiptarëve për liri është themeli, mburoja dhe simboli i lirisë së Kosovës. Selimi ka thënë se lufta çlirimtare ishte luftë e drejtë e popullit të Kosovës dhe amanet i Adem Jasharit. “Jam krenare që isha pjesë e asaj lufte me pushkë në dorë. Marsi i Jasharëve dhe i UÇK-së tregon fuqishëm se lufta çlirimtare nuk tjetërsohet. Ashtu si në çdo mars, edhe sot populli e di se ku i ka rrënjët liria”, ka thënë Selimi.

Në anën tjetër, deputetja e AAK-së, Time Kadrijaj, ka thënë se datat 5, 6 dhe 7 mars janë datat e kthesës historike të Kosovës. Ajo ka thënë “Epopeja e UÇK”-së ka kulmuar pas përpjekjes shekullore të brezave për liri. “Një familje si në legjenda luftoi me heroizëm, duke mos rënë asnjë i gjallë në dorën e armikut. Aty ranë heroikisht për të mos vdekur kurrë. Ai që do të mbetet i gjallë gjithmonë është komandant Adem Jashari. Lufta dhe sakrificat e Jasharëve mobilizoi shqiptarët në gjithë botën. Se lufta e Adem Jasharit ishte e drejtë, dëshmojnë se krah saj u bënë aleatët më të mëdhenj. Nëse ka diçka shumë të vlefshme që duhet të krenohen fort shqiptarët kudo që janë, është Ushtria Çlirimtare e Kosovës”, ka thënë ajo.

Manifestimi tradicional “Epopeja e UÇK”-së mbyllet sonte (e martë) me “Natën e Zjarreve”.



## BE-ja dhe Qeveria e Kosovës ndajnë sot 45 bursa për studime master në Evropë

PRISHTINË, 6 MARS (ER) - 45 bursa të reja do të ndahen sot (e martë) në Prishtinë nga Bashkimi Evropian dhe Qeveria e Kosovës për studime master në vendet evropiane për të diplomuarit rishtazi dhe nëpunës civilë nga Kosova.

Bursat ndahen në kuadër të programit Young Cell Scheme

(YCS) të bashkëfinancuar nga BE-ja, i cili funksionon që nga viti 2004 dhe nga i cili deri më tani kanë përfituar 364 të reja e të rinj. Synimi i programit është përmirësimi i punës së administratës publike të Kosovës dhe cilësisë së shërbimeve që ajo u ofron qytetarëve, duke mbështetur arsimimin e lartë të

nëpunësve civilë aktualë dhe të ardhshëm.

Në këtë ngjarje pjesëmarrës do të jetë shefi i Zyrës i BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog dhe zëvendëskryeministri i parë i Republikës së Kosovës, Besnik Bislimi. Ndarja e bursave do të bëhet në orën 11:00 në ambientet e "Kino Armata" në Prishtinë.



## KMDLNj-ja: Qytetarët në mënyrë të organizuar ta kundërshtojnë shtrenjtimin e rrymës

PRISHTINË, 6 MARS (ER) - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) është deklaruar kundër

paralajmërimeve për shtrenjtimin e energjisë eklektike. "Kohë më parë KMDLNj-ja paralajmëroi se ZRrE-ja, ky institucion diskriminues ndaj qytetarëve dhe favorizues ndaj KESCO, do të miratojë rritjen e faturave për energji elektrike në masë prej 13.4 për qind e që doli të jetë i vërtetë, por tash në masë prej 14 për qind. Realisht, rritja e çmimit për faturat e energjisë elektrike nuk mbetet një rast i izoluar por, pashmangshëm përcillet me rritje të çmimeve të artikujve të tjerë, kryesisht artikujve elementarë dhe të domosdoshëm për ekonomitë familjare që, edhe ashtu janë të cenueshme dhe me vështirësi po i përballojnë edhe çmimet aktuale. Në të njëjtën kohë Qeveria e Kosovës, në mënyrë shumë bujare vazhdon t'ua paguajë rrymën serbëve në veri të Kosovës duke shpenzuar afërsisht 63 milionë euro në vitin 2022 për këtë akt 'bamiresie' për qytetarë që janë deklaruar se janë shtetas të një shteti tjetër dhe që pamëshirshëm e shpenzojnë rrymën, jo vetëm për nevoja familjare por edhe për aktivitete kriminale siç janë prodhimi i kriptovalutave dhe kultivimi i lëndëve narkotike që kërkojnë sasi të mëdha të energjisë elektrike", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

Sipas këtij reagimi, Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj ka deklaruar se vazhdimi i pagesës së energjisë elektrike për serbët dhe të tjerët në veri të Kosovës është në kundërshtim me ligjin dhe se cenon parimin kushtetues për barazinë e të gjithë qytetarëve. "Me një fjalë është në



kundërshtim me frymën kushtetuese dhe është veprim diskriminues. KMDLNj-ja në shumë reagime publike ka kërkuar nga të gjitha qeveritë e Kosovës që të ndërprejnë pagesën e faturave të energjisë elektrike në bazë të parimit etnik, favorizues për serbët dhe përjashtues për shqiptarët dhe të tjerët (pagues të rregullt të faturave) dhe se faljen e pjesshme apo të krejt borxhit ta bëjnë vetëm sipas parimit ekonomik dhe social, pavarësisht përkatësisë etnike", është thënë në këtë reagim.

Në këtë kontekst, KMDLNj-ja ka kërkuar nga qytetarët që në mënyrë të organizuar ta kundërshtojnë shtrenjtimin e

rrymës. "Qytetarët e Kosovës, me të drejtë të pakënaqur me këtë paralajmërim të shtrenjtimit të rrymës e që do të përcillet nga ngritja zinxhirore e çmimeve të artikujve tjerë dhe të shërbimeve nuk duhet të ndalen vetëm me një reagim të çastit në KMDLNj-ja apo te Avokati i Popullit por duhet të organizohen, përmes aktivizmit qytetar në mbrojtje të interesave të tyre aq më parë që kategoritë e cenueshme; pensionistët, përfituesit e skemave pensionale, veteranët dhe invalidët e luftës, viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës që nga fillimi i zbatimit për përkrahje financiare, kompensimet apo lëmoshat sociale që i marrin nuk janë rritur

aspak në ndërkohë që çmimet kanë shkuar në qiell. Në pamundësi të krijojnë kushte për një jetesë të dinjitetshme, institucionet e Kosovës nuk po krijojnë kushte as për mbijetesë andaj edhe po kemi migrim aq të madh të popullatës, të rinjve kryesisht sepse të moshuarit dhe të sëmurët nuk i do askush dhe nuk kanë ku të shkojnë", është thënë në reagimin e KMDLNj-së, duke shtuar se qytetarëve të Kosovës po u rrezikohet mbijetesja. "Qytetarët të cilëve me këto shtrenjtime dhe ngrirje të thellë të të ardhurave të tyre, seriozisht po iu rrezikohet mbijetesja duhet të përdorin të gjitha mjetet e lejuara demokratike për të kundërshtuar

shtrenjtimin e çmimeve dhe shërbimeve sikur edhe për të kundërshtuar keqpërdorimin e taksave të tyre me të cilat iu paguhet rryma serbëve dhe të tjerëve në veri të Kosovës, që nga përfundimi i luftës e deri më sot. Problemet me të cilat përballen qytetarët e Kosovës, pa fajin e tyre dhe në kërkim të një jete më të mirë dhe më të dinjitetshme është themeli mbi të cilin duhet të ndërtohet reagimi qytetar, pa dallim në baza etnike, përkatësisë politike, gjinisë, moshës, besimit apo kulturës që i përket. Nëse reagimi qytetar do të jetë vetëm reagim i çastit, reagim i mllefrit, institucionet do të vazhdojnë me këto shtrenjtime, në mungesë të një reagimi të vendosur qytetar. Deputetët, si përfaqësues të popullit nga edhe e kërkojnë votën dhe e fitojnë të drejtën e përfaqësimit, tash për të gjithë qytetarët e Kosovës, duhet ta kundërshtojnë këtë shtrenjtim, qoftë në kuadër të komisioneve përkatëse të Kuvendit ashtu edhe në seancat parlamentare, pa bërë dallime partiake dhe pa u përpjekur ta kapitalizojnë këtë kundërshtim politikisht. Të drejtat e njeriut nuk nënkuptojnë vetëm mbrojtje nga dhuna fizike, verbale dhe shpirtërore por edhe garantimi i kushteve të dinjitetshme për një shkollim cilësor, shërbime shëndetësore profesionale dhe të përbalueshme, kushte banimi të përshtatshme, por edhe një mundësi për një jetë kualitative përmes sigurimit të një page që siguron këtë jetë sikur edhe sigurimi të një pensioni në përputhje me kontributin e dhënë dhe nevojat shëndetësore dhe të tjera për pensionistët dhe grupet e tjera të cenueshme", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

## Komuna e Prishtinës i obligon lokalet të pajisen me matës të zhurmës

PRISHTINË, 6 MARS (ER) - Komuna e Prishtinës i ka njoftuar lokalet në sektorin e gastronomisë, se me rregulloren e re duhet të pajisen me certifikatë që përcakton orarin e punës dhe decibelët e lejuar të zhurmës. "Ju njoftojmë se me rregulloren e re në fuqi për matjen e zhurmës, subjektet

afariste në sektorin e gastronomisë në kryeqytet obligohen të furnizohen me pajisje që matin nivelin e zhurmës së emituar jashtë, rrjedhimisht të pajisen me certifikatë që përcakton orarin e punës dhe decibelët e lejuar", është thënë në njoftimin e komunës së Prishtinës. Sipas njoftimit, subjektet

afariste si: kafenetë, restaurantet, baret, klubet e natës dhe të gjitha hapësirat e gastronomisë në kuadër të lokaleve që ushtrojnë veprimtari të ndryshme, ta shfrytëzojnë afatin e aplikimit deri më 13 mars 2023, në ora 16:00, për vendosjen e pajisjeve për matjen e nivelit të zhurmës.



## PSD-ja shtron para qeverisë 205 mijë nënshkrimet kundër asociacionit

Prishtinë, 6 mars - Partia Socialdemokrate (PSD) ka vendosur para Qeverisë së Kosovës 205 mijë nënshkrimet e peticionit të vitit 2016 kundër Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Me këtë rast, kryetari i PSD-së, Dardan Molliqaj, ka thënë se kryeministri Albin Kurti po e shkel me të dyja këmbët

vullnetin e qytetarëve. Sipas tij, peticioni i shtrirë para shkallëve të qeverisë është rruga mbi të cilën ka shkelur Kurti me pajtimin e tij në Bruksel. "Mbi këtë rrugë eci dhe u ngrit. Nga po e njëjta do të rrëzohet, sepse vullneti i shprehur kundër Asociacionit (2015) nuk e duron gjatë mohimin. Qeveria e Republikës

së Kosovës e ka braktisur vullnetin qytetar dyfish. Njëherë duke e braktisur peticionin me mbi 205 mijë nënshkrime të vitit 2015 dhe 2016 kundër marrëveshjeve me Serbinë, veçanërisht asaj që është për Asociacionin dhe vullnetin e dytë atë të zgjedhjeve të 14 shkurtit 2021", ka thënë Molliqaj.



## A do ta nënshkruajnë Kosova dhe Serbia më në fund një marrëveshje?

PRISHTINË, 6 MARS - Më 27 shkurt kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe presidenti serb, Aleksandër Vuçiq, kanë pranuar një propozim të Bashkimit Evropian në Bruksel, të titulluar "Marrëveshja drejt normalizimit Kosovë - Serbi".

Marrëveshja - për të cilën janë bërë përgatitje prej vjeshtës së vitit 2022 mbulon shumë aspekte në marrëdhëniet mes dy vendeve - nuk është nënshkruar ende, mirëpo është publikuar zyrtarisht nga Bashkimi Evropian. Vlen të përmenden disa pika të saj.

Një zyrtar i lartë i BE-së, i afërt me këto zhvillime, i ka thënë "Radios Evropa e Lirë" se tekstit i mungon validiteti pa një aneks të cilin pritet ta përgatitin palët para takimit të tyre të ardhshëm, që do të mbahet në Ohër të Maqedonisë së Veriut më 18 mars.

Ky fakt e bën pikën e 11-të të marrëveshjes, e cila thekson se "të dyja palët duhet ta respektojnë udhërrëfyesin e zbatimit të kësaj marrëveshjeje", pjesën më të rëndësishme.

Plani për këtë udhërrëfyes, i cili përfshin kohën e zbatimit të marrëveshjes, ekziston, por ka ende punë për t'u bërë.

Marrëveshja në thelb është një shtesë e marrëveshjes së arritur më 2013 në Bruksel, në mes të Prishtinës dhe Beogradit, e cila ka paraparë normalizimin e marrëdhënieve, pasi Kosova e ka shpallur pavarësinë më 2008 - veprim që Serbia nuk e ka pranuar kurrë.

Kosova, Serbia dhe BE-ja janë duke tentuar ta përditësojnë marrëveshjen e një dekade më parë, për ta zhbllokuar rrugën drejt integriteteve evropiane, pa një obligim zyrtar ndaj Beogradit për ta njohur pavarësinë e Kosovës - të paktën tani për tani.

Ndonëse Serbia i ka hapur negociatat me BE-në një vit pas



marrëveshjes së Brukselit, pra më 2014, deri më tani e ka harmonizuar politikën e saj me të BE-së në vetëm dy fusha, nga 34 sa janë në total.

Përdërisa pesë vende të BE-së ende nuk e njohin pavarësinë e Kosovës, ky shtet mbetet i vetmi në Ballkanin Perëndimor që nuk është kandidat për anëtarësim në BE dhe aplikimi i tij, i dorëzuar vitin e kaluar, ende nuk është trajtuar me seriozitet nga blloku evropian.

Kjo i bie se Prishtina as nuk mund ta nisë punën drejt harmonizimit të politikave.

Një prej pikave më të rëndësishme të marrëveshjes së vitit 2013 është krijimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë.

Kryeministri Kurti e ka ndërtuar një pjesë të mirë të suksesit politik mbi refuzimin për të formuar këtë asociacion, duke argumentuar se

një strukturë e tillë do të krijonte probleme të ngjashme me ato të Bosnjë-Hercegovinës, ku entitetet e përqendruara në baza etnike i bëjnë reformat vështirë të realizueshme. Marrëveshja aktuale nuk e përmend fjalë për fjalë Asociacionin, mirëpo thekson se "Beogradi dhe Prishtina duhet të garantojnë një nivel të duhur të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë dhe mundësinë e ofrimit të shërbimeve në fusha të caktuara, përfshirë ofrimin e mbështetjes financiare nga Serbia dhe një kanal të drejtpërdrejtë komunikimi për komunitetin serb me Qeverinë e Kosovës". Pyetja është nëse mund të funksionojë një gjuhë e tillë e paqartë.

Ndoshta Kurti mund ta shesë këtë pikë në publik si diçka tjetër dhe jo si Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe, ndonëse brumi

është i njëjtë, ndërsa Vuçiqi, në anën tjetër, të argumentojë se Beogradi ka ende mundësi t'i mbështesë politikisht dhe financiarisht serbët e Kosovës. Prej publikimit të dokumentit të fundit, Vuçiqi ka këmbëngulur se nuk do ta njohë kurrë pavarësinë e Kosovës dhe as nuk do të pranojë që ajo të anëtarësohet në Kombet e Bashkuara. Megjithatë, ky qëndrim është në kundërshtim me pikat e marrëveshjes së re, sidomos me pikën 4, e cila qartëson se "Serbia nuk do ta kundërshtojë anëtarësimin e Kosovës në çfarëdo organizate ndërkombëtare". Testi real i përparimit mund t'u prezantohet palëve këtë pranverë. Fillimisht, Kosova po synon të bëhet pjesë e Këshillit të Evropës dhe, së dyti, 27 vendet anëtare të BE-së do të kuptohet nëse do të arrijnë konsensus për të dërguar në

Këshillin Evropian aplikimin e Kosovës për anëtarësim në BE.

Në të dyja rastet, Beogradi besohet se ka punuar në prapaskenë për ta penguar përparimin në këto dy drejtime, kanë thënë disa zyrtarë evropianë që kanë njohuri me këto zhvillime, por që nuk janë të autorizuar për të diskutuar këtë temë në medie.

Vlen të përmendet, po ashtu, se ndonëse marrëveshja nuk e detyron Beogradin ta njohë ligjërisht shtetësinë e Kosovës, në marrëveshje përmendet ajo që konsiderohet njohje de facto, duke përfshirë nevojën për "njohje reciproke të dokumenteve dhe simboleve kombëtare, duke përfshirë pasaportat, diplomat, targa e makinave dhe vulat doganore" si dhe këmbimin e misionëve të përhershme në kryeqytetet respektive.

## Ambasadori Hill: Formimi i asociacionit, test për Kosovën

BEOGRAD, 6 MARS - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Beograd, Christopher Hill, ka folur sërish për çështjen e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Ai në një panel për të ardhmen e Bashkimit Evropian (BE) dhe Ballkanin Perëndimor është shprehur se marrëveshjet e arritura

duheshin respektuar dhe se ky ishte një test për autoritetet në Kosovë.

Në këtë kontekst, ambasadori Hill është shprehur se Asociacioni duhej të formohej, veçanërisht pasi ishte paraparë në marrëveshjen e arritur 10 vjet më parë. "Arsyeja e dytë është se nuk duhet të jesh historian apo

antropolog për ta ditur që serbët kanë jetuar me shekuj në Kosovë dhe kanë të drejtë që ta vendosin për të ardhmen e tyre", ka thënë ambasadori Hill, raporton "Kosovo-Online".

Ambasadori Hill është shprehur se BE-ja ishte "gjëja më e mirë që kishte ndodhur në shekujt e fundit".



## Tregjet e aksioneve në botë e nisin javën me rritje

**PRISHTINË, 6 MARS** - Tregjet evropiane janë hapur me rritje në sesionin e parë të kësaj jave pas fitimeve modeste të javës së kaluar.

Indeksi "pan-European Stoxx 600" e ka nisur ditën me rritje rreth 0.3 për qind, ndërsa sektori i shitjeve me pakicë ka kryesuar fitimet në rritje me rreth 0.8 për qind.

Shumica e tregjeve në rajonin e Azi-Paqësorit kanë pasur një performancë mikse pasi qeveria kineze ka vendosur një objektiv të rritjes ekonomike prej 5-përqindësh gjatë këtij viti. Në dëshminë që pritet ta mbajë në Kongresin amerikan presidenti i FED, Jerome Powell mund të japë detaje mbi ecurinë e normave të

interesit dhe mbi gjendjen e ekonomisë. Gjithashtu, tregjet po presin edhe raportin mbi punësimin në ShBA për muajin shkurt dhe analistët presin 255 mijë vende të reja pune. Investitorët janë duke pritur edhe të dhënat mbi shitjet me pakicë në Eurozonë për janarin dhe prodhimin industrial për Gjermaninë.



## Nga 2 marsi Kosova nuk është duke marrë energji elektrike nga Shqipëria

**PRISHTINË, 6 MARS** - Nga 2 marsi Kosova nuk është duke marrë energji elektrike nga Korporata Energjetike e Shqipërisë (KESH). Nuk është sqaruar zyrtarisht shkaku pse Kosova nuk po vazhdon të importojë rrymë nga Shqipëria qoftë si kthim borxhi të energjisë elektrike të deponuar në KESH, gjatë muajve të verës, qoftë si huamarrje (këmbim i rrymës në bazë të disa marrëveshjeve të nënshkruara në këto vite për këmbimin e rrymës në raste të disponimit të tepercave).

Sidoqoftë, këtyre ditëve konsumi i Kosovës po furnizohet kryesisht nga prodhimi vendor i rrymës, përkatësisht nga energjia elektrike që prodhojnë termocentralet e KEK-ut që janë operative (B1 dhe B2 të Kosovës B dhe A3 e A4 të Kosova A) dhe që po vazhdojnë të funksionojnë mirë dhe në këto ditë të ftohta po imponojnë me gatishmërinë teknike të turbinave dhe të kaldajave përkundër vjetërsisë së tyre të madhe dhe amortizimit nga puna e pandërprerë me decenie me radhë. Po të llogaritet gjithsej prodhimi aktual në këto katër njësi të prodhimit të energjisë elektrike nga termocentralet e vendit që janë funksionale, del që B1, B2 dhe A3 e A4-shi po prodhojnë bashkërisht rreth



780 megavatë orë rrymë. Skender Bucolli, zëdhënës i Korporatës Energjetike të Kosovës, i ka thënë "Buletin Ekonomik" se aktualisht në prodhim gjenden katër termocentralet të vendit (blloqet B1 dhe B2 të Kosovës B dhe A3 e A4 të Kosovës A), të cilat prodhojnë rreth 760-780 megavatë orë energji elektrike së bashku.

Siç dihet, blloqet B1 dhe B2 të Kosovës B kanë bashkërisht

kapacitet në rrjet rreth 520 megavatë, ose secili bllok aktualisht prodhon rreth 260 megavatë orë. Ndërsa blloku A3 dhe A4 i termocentraleve Kosova A, kapacitetin në rrjet e kanë rreth 130 megavatë orë, që do të thotë se bashkërisht prodhojnë 260 megavatë. Po të llogaritet gjithsej prodhimi aktual në këto katër njësi të prodhimit të energjisë elektrike nga termocentralet e vendit që janë funksionale, del

që B1, B2 dhe A3 e A4-shi po prodhojnë bashkërisht rreth 780 megavatë orë rrymë. Kësaj sasi të energjisë elektrike të prodhuar nga TC-të duhet shtuar plus një sasi simbolike, diku rreth 50-60 megavatë orë, herë-herë edhe më shumë, të energjisë së rinovueshme që prodhohet në vend (nga hidrocentralet e vogla të Kosovës dhe nga parqet e energjisë në bazë të erës në Shalë të Bajgorës dhe në Kitkë

të Anamoravës).

Bucolli ka thënë se gjatë 24 orëve të fundit nga termocentralet e KEK-ut janë prodhuar mbi 17 mijë megavat orë energji elektrike dhe e tërë kjo sasi është vënë në dispozicion të distributorit, pos një sasi më të vogël, rreth 80-90 megavatë orë që i dedikohen Termokosit si energji termike për ngrohje. Nga KEDS-i nuk është bërë me dije se sa janë nevojat për të importuar këto ditë, me temperatura relativisht të ulëta gjatë natës.

Gjithsesi, mungesa e energjisë elektrike nga Shqipëria, që për muaj të tërë ishte një ndihmesë e madhe për stabilitetin e sistemit ekektroenergjetik të vendit, do të ndihet këtyre ditëve të ftohta, kur konsumi i rrymës në Kosovë rritet ndjeshëm, sidomos gjatë orëve të pikut. Dhe kosovarët nuk kanë shumë alternativa në mungesë të rrymës së vet dhe nevojave për energji elektrike. Prandaj, kursimi i rrymës dhe ulja e shpenzimit janë kushtimisht të domosdoshme dhe alternativat që na presin sa i përket sigurimit të energjisë elektrike të munguar. Kosova nuk ka zgjidhje tjetër edhe në ditë në vijim, pos reduktimeve të kushtëzuara, kursimit të domosdoshëm të gjithsecilit konsumator.

## 273 fermerë të Vushtrrisë përfitojnë serra për kultivimin e prodhimeve vendore

**VUSHTRRI, 6 MARS** - Komuna e Vushtrrisë ka mbajtur ceremoninë e ndarjes së serrave. Në thirrjen e komunës kanë përfituar 273 fermerë.

Kryetari i komunës së Vushtrrisë, Ferit Idrizi, ka bërë me dije se këto serra janë financuar nga kjo komunë dhe Islamic Relief Kosova, me qëllim për t'i ndihmuar ekonomitë familjare.

Idrizi ka thënë se për përzgjedhjen e fermerëve fitues është angazhuar një komision, i cili, sipas tij, ka bërë një punë të mirë. "Edhe të ndarja e serrave ne me vendim e kemi caktuar një komision, që unë e kam pasur besimin e

plotë dhe besoj se ka kryer punën më të mirë në këtë drejtim të ndarjes së serrave. Nuk ka qenë punë e lehtë sepse është dashur të identifikohet secili rast veç e veç në terren, por vërtet e ka bërë një punë të mirë", ka thënë Idrizi.

Ai ka treguar se subvencionet për bujqësi janë rritur nga 140 mijë euro në 450 mijë. "Komuna e Vushtrrisë, vlen të theksohet, i ka rritur subvencionet për fushën e bujqësisë nga 140 mijë euro sa kanë qenë, në mbi 450 mijë euro, me qëllim që t'i ndihmojmë bujqit dhe fermerët", është shprehur

Idrizi, duke shtruar se janë munduar që ndarja të jetë sa më e drejtë në mënyrë që mos të ankohet askush. "Pra jemi munduar që kjo ndarje të jetë e drejtë në mënyrë që të mos ankohet dikush nga padrejtësitë dhe të gjitha ato që i kemi ndarë vitin e kaluar ju them sinqerisht nuk e kemi pasur asnjë ankesë, për arsye se kanë përfituar të gjithë qumështarët, për arsye se kanë përfituar të gjithë bletarët, për arsye se kanë përfituar edhe blegtorët e bagëtive të imëta, të deleve dhe të dhive dhe kanë përfituar edhe fermerët e buallicave", ka thënë Idrizi.





# Filozofi polarizues francez zgjedh zonat e luftës e jo sallat e pritjes

Nga: Dan BILEFSKY /  
The New York Times  
Përkthimi: Agron Shala

Në filmin e tij të ri dokumentar “Slava Ukraini” [Lavdi Ukrainës], intelektual i famshëm publik i Francës, Bernard-Henri Lévy, shmang zjarrin e snajperit rus në Ukrainë duke mbajtur veshur – si noshalant – jelekun antiplumb ngjyrë kaki mbi kostumin elegant të bërë me porosi.

Me flokët e thinjura që fryhen butësisht nga era, në Odesë ngjitet në anijen e marinës ukrainase që pastronte Detin e Zi nga minat ruse. Dhe, vëzhgoi blloqet e apartamenteve të shkatërruara në Kiev, zbriti në hendekë me ushtarët ukrainas në Sloviansk dhe e ngushëlloi nënën – djali i vogël i së cilës është aq i traumatizuar nga lufta sa që ka pushuar së foluri.

Mund të jetë e lehtë mos ta vëresh Lévy-in – dhe shumë këtë e bëjnë – si një turist të pakujdesshëm 74-vjeçar të luftës, si trashëgimtar të një pasurie të lëndëve të drurit duke e luajtur heroin e aksionit në kohën kur raketat ruse bien mbi Kiev, Harkiv dhe Mariupol. Por, në vend që t’i kalonte 12 muajt e fundit në shtëpinë e tij të mbushur me art – në bregun e djathtë të Parisit – ose ta shijonte pensionin në pallatin e tij të shekullit XVIII në Marakesh, Lévy ka qenë i guximshëm ndaj sulmeve ushtarake ruse, ndaj vorbullës dhe asaj që e quan prirje të tij të natyrshme për melankolinë për ta bërë filmin e tij në Ukrainë.

Ishte, tha ai, protestë [cri de coeur] e domosdoshme për ta mbështetur Ukrainën në konfliktin që ai e sheh si asgjë më pak sesa një betejë për të ardhmen e Evropës, për liberalizmin global dhe për qytetërimin perëndimor.

“Në Ukrainë për herë të parë pata ndjesinë se mund të shembet bota që unë e njihja, bota në të cilën u rrita, bota që dua t’ua lë fëmijëve dhe nipërve të mi”, tha ai gjatë një interviste në Hotelin “Carlyle” të Nju-Jorkut, në fillim të këtij muaji, ku e piperoste theksin e vet – porse të anglishtes së rrjedhshme – me aludime për Clausewitz-in, Hegel-in dhe letërsinë vjeneze.

Filozof, shkrimtar, personalitet televiziv dhe regjisor, Lévy është shpikje kryesisht franceze, e një vendi që çmon intelektualët publikë po si yjet e popit. Është i kudondodhur në Francë sa që njihet thjesht si B.H.L., me inicialet e ngjashme të një marke luksoze franceze. Por, është gjithashtu personazh thellësisht polarizues, i tallur nga disa kritikë si filozof diletant ose i frazave përmbledhëse. Por, Lévy duket i përbajtur nga kritikë, duke e parë punën e tij si një thirrje më të lartë.

“Thirrja morale nuk hesht kurrë për mua”, tha Lévy. “Në ndonjë moment mendoj se nuk do të kem më forcë t’i përgjigjem kësaj thirrjeje”.

“Slava Ukraini” – “Lavdi Ukrainës” – u dha premierë në Francë më 22 shkurt dhe në muajt e ardhshëm pritet të dalë në Shtetet e Bashkuara. Është xhiruar gjatë vitit të kaluar, gjatë më shumë se 10 udhëtimeve që Lévy bëri në Ukrainë. Filmi (i dyti



i Lévy-it për konfliktin atje) ka marrë lëvdata për portretizimin e tij – pa hezitim – të tmerreve të luftës. “Pa dyshim, Lévy kurrë nuk ka filmuar dhe nuk e ka bartur shqetësimin dhe vdekjen me kaq ashpërsi dhe me kaq vrazhdësi të papërkulshme”, vuri në dukje “L’Express”, një revistë franceze me ndikim.

Lévy i ka kaluar pesë dekadat e fundit duke iu lutur Perëndimit që të ndërhyjë në konfliktet në dukje të pazgjidhshme, duke u futur në fushat e betejës në vendet si Bosnja, Darfuri, Ruanda, Kurdistani, Afganistani dhe Libia.

Këtë herë, megjithatë, ai tha se aksionet ishin shumë më të rënda. Ai paralajmëron se nëse nuk ndalet presidenti i Rusisë, Vladimir V. Putin, do të ketë Luftë të re të Ftohtë, me Moskën, Teheranin, Kinën, Turqinë dhe fundamentalistët islamikë që e kërcënojnë botën dhe me despotët e fuqizuar bërthamorë që shantazhojnë Perëndimin. Ata në Kongresin e ShBA-së dhe në kryeqytetet evropiane që u ankuar se armatosja e Ukrainës ishte gjithë shumë e shtrenjtë, tha ai, ishin thjeshtë “të marrë”.

Dhe, pse vesh kostume të porositura në një zonë lufte? “Veshja nuk është e rëndësishme, por është një nga shenjat e vogla të respektit”, për popullin e Ukrainës, shpjegon Lévy. I lindur në Algjerinë franceze në vitin 1948, në një familje hebraike sefardike, Lévy në vitet 1970 shpërtheu në skenën kombëtare në Francë, si filozof i ri me flokë të gjata që bënte me dije për rreziqet e marksizmit në të majtën franceze. Ka shkruar dhjetëra libra duke mbuluar politikën, filozofinë, judaizmin dhe identitetin amerikan. E bashkëthemeloi një grup me ndikim kundër racizmit dhe u bë figurë e dashur mediatik të cilin e dëgjonin presidentët francezë.

Megjithatë, vazhdon të tërheqë përbuzjet. Është qortuar për mbështetjen e tij të hapur ndaj

Roman Polanski-t dhe Dominique Strauss-Kahn-it, që të dy këta të akuzuar për abuzim seksual të grave. I është zënë të paktën tetë herë prita nga një hedhës belg i piteve që në shënjestër ka personazhet pompoze, dhe është subjekt i jo më pak se katër biografive që me raste janë përbuzëse. Atij shpeshherë i atribuohet aforizmi: “Zoti ka vdekur, por flokët e mia janë të përsosura”. “Nuk e kam thënë kurrë, është rrenë”, tha ai. “Jam i gatshëm ta shoh si diçka qesharake.”

Disa kritikë kanë vënë gjithashtu në pikëpyetje rigorozitetin e tij metodologjik. Në librin e tij të vitit 2010, “Për luftën në filozofi”, Lévy gjerësisht citon Jean-Baptiste Botulin, një filozof të shekullit XX dhe krijues i shkollës së mendimit të njohur si Botulizëm. Por, Botul-i nuk ka ekzistuar kurrë dhe është shpikje satirike e shkrimtarit Frédéric Pagès. Lévy, në atë kohë, ishte i penduar dhe e lavdëroi mashtuesin për këtë mashtim.

Jade Lindgaard, gazetare franceze dhe bashkëautore e librit “Mashtuesi: BHL në vendin e çudirave”, që është një analizë kritike ndaj Lévy-it dhe punës së tij, ka pohuar se është zbehur ndikimi i Lévy-it, pjesërisht për shkak se ishte jashtë kontaktit me çështjet bashkëkohore, si ndryshimet klimatike dhe lëvizja #MeToo. “Për mua, ai e ka humbur besueshmërinë, ndoshta për shkak të të gjitha gabimeve që ka bërë në shkrimet e veta”, shkroi ajo në një email, duke shtuar se stili i tij personal e ka minuar vetë atë.

Por, mbrojtësit e tij i përshkruajnë sulmet si diçka që ka të bëjë me xhelozinë për pasurinë, fuqinë dhe suksesin e tij. (Është i martuar me aktoren dhe këngëtare Arielle Dombasle.) Ai është, thonë ata, njeriu që synon t’i japë formë historisë, jo thjesht ta shkruajë atë. “Këta njerëz që e kritikojnë janë

intelektualë të kolltukëve që nuk largohen kurrë nga sallonet e tyre parisiane”, tha Marc Roussel, bashkëregjisor i “Slava Ukraini”.

Lévy tha se momenti i tij i parë edukues – që e frymëzoi të linte pas klithmat bosh të bankave të studimit – erdhi në fillim të të 20-tave kur ia vuri veshin thirrjes së romancierit francez André Malraux, për të ndihmuar separatistët nga Bangladeshi që luftonin kundër Pakistanit. Në vitin 1971, udhëtoi për në Bangladesh në sulmin e tij të parë si korrespondent lufte.

“Në atë moment, vendosa të tentoj të bëj diçka që do të ndodhë, t’i përlyej duart e mia në historinë reale”, tha ai.

Në vitin 1977, Lévy shkroi “Barbarizmi me fytyrë njerëzore”, në të cilin hodhi poshtë marksizmin dhe maoizmin. Në vend të kësaj, ai tha se ka filluar ta përqafojë si filozofi udhërrëfyese nocionin “tikkun olam” – idenë se hebrejtë e kanë përgjegjësinë për ta “riparuar botën” përmes veprave të mira. Lévy tha se yll orientues kishte babanë e vet, André Lévy, një njeri që e ndërtoi suksesin e vet e që nga Algeria kishte ikur nga varfëria – si adoleshent në vitet 1930 – dhe që ishte vullnetar për t’i luftuar republikanët në Spanjë, kundër Frankos, përpara se të bashkohej me ushtrinë e Francës së Lirë dhe të luftonte kundër nazistëve.

Kur u përball me perspektivën e snajperëve serbë të Bosnjës, në Sarajevë, me luftëtarët e ISIS-it në shpellat e Kurdistanit ose me zjarrin e mortajave ruse në Ukrainë, Lévy tha se shpeshherë mendonte për trimërinë morale dhe guximin fizik të babait të vet.

“Për të pasur kurajo, mendoj për babanë tim duke u ngjitur në Monte Kasino me një grup luftëtarësh marokenë dhe duke e pushtuar majën”, tha ai, duke iu referuar një betejë të përgjakshme të Italisë më 1944, që ndihmoi aleatët që ta

thyejnë mbrojtjen gjermane.

Lévy tha se besimi i tij në fuqinë e individëve, për ta zgjuar botën, u forcua gjatë luftës në Bosnje në vitet 1990, kur ai shkoi në Sarajevë. Fillimisht kishte dashur të organizonte një brigadë ndërkombëtare për të ndihmuar forcat boshnjake myslimane që luftonin kundër serbëve, por vendosi se do të ishte gjë më efektive që ta bënte një film. Babai, i cili iu lut që të mos shkonte në Bosnje, në fund e financoi realizimin e filmit që ndihmoi të hidhej dritë mbi minoritetë serbe kundër myslimanëve.

“Bosnja ma bëri me dije se idetë kanë rëndësi, se fjalët mund ta bëjnë ndryshimin, se vendimmarrësit mund të binden dhe se individët mund të jenë një kokërr rëre që bllokun makinerinë”, tha Lévy.

Në vitin 2011, në një periudhë afërsisht dyjavore, Lévy luajti rol vendimtar për ta nxitur presidentin Nicolas Sarkozy që të ndërhyjë në Libi, duke ndihmuar në hapjen e rrugës për Francën, Shtetet e Bashkuara dhe NATO-n në mbështetjen e një grupi të ri opozitar, si dhe për ta zhvilluar luftën që ndihmoi në rrëzimin e liderit libian – të kolonelit Muammar el-Gaddafi.

Lévy tha se ndërhyrja në Libi ishte “gjëja e duhur për t’u bërë”. Por, disa kritikë të kësaj lëvizjeje theksojnë se Libia që atëherë është kthyer në kaos.

Derisa Lévy është i lidhur ngushtë me Francën, ai tha se dy modelet e tij kryesore ishin Ernest Hemingway, njeriu fizikisht imponues dhe i aksionit që mbuloi Luftën Civile të Spanjës, si dhe F. Scott Fitzgerald, mbreti – i dhënë pas alkoolit – i Epokës së Xhazit të Parisit të viteve 1920.

“Më pëlqen të mendoj me këmbët e mia, me duart e mia, me mushkëritë e mia, me mishin tim”, tha ai.



Veton Zymberi, redaktor i sportit

## KOK-u rrit për 2 880 euro në muaj vlerën e bursave olimpike 'Paris 2024'

PRISHTINË, 6 MARS - Bordi Ekzekutiv i KOK-u ka vendosur që deri në Lojërat Olimpikë "Paris 2024" të rritë vlerën e bursave olimpikë për 22 bursistët e KOK-ut. Rritja është bërë në bazë të rezultateve të arritura nga sportistët gjatë vitit 2022. Rritja më e madhe, prej 300 eurosh, është bërë për kampionet olimpikë Distria Krasniqi e Nora Gjakova, nënkampionen e Evropës 2022, xhudisten Laura Fazliu dhe medalistët e bronzë në Lojërat Mesdhetare, xhudisten Flaka Loxha e boksierin Shpëtim Bajoku. Nga 250 euro më shumë do të marrin edhe boksierja Donjeta Sadiku, medaliste e bronzë e botës dhe



Evropës dhe xhudistja Loriana Kuka, medaliste e artë në LM "Oran 2022". Vlera totale mujore e rritjes është 2 880 euro. Qëllimi

i dhënies së bursave olimpikë është përgatitja dhe ndjekja e normës olimpikë për "Paris 2024".

### LISTA

**1300 Euro**  
Distria Krasniqi (xhudo)  
Nora Gjakova (xhudo)

**850 Euro**  
Donjeta Sadiku (boks)  
Loriana Kuka (xhudo)

**750 Euro**  
Akil Gjakova (xhudo)  
Laura Fazliu (xhudo)

**650 euro**  
Egzon Shala (mundje)

**600 euro**  
Muhamet Ramadani (atletikë)  
Shpëtim Bajoku (boks)  
Flaka Loxha (xhudo)

**500 euro**

Erza Muminoviq (xhudo)

**380 euro**

Lorand Gjoshi (kajakim)  
Arnis Agushi (taekwondo)  
Eda Zeqiri (not)  
Edi Dvorani (shigjetari)  
Nexhat Sahiti (shenjëtari)  
Shpati Zekaj (xhudo)  
Albion Ymeri (triathlon)  
Gresa Bakraqi (atletikë)

**250 euro**

Alaudin Suma (atletikë)  
Arbër Azemi (taekwondo)  
Patriot Behrami (boks)

## Sonte përcaktohen dy çerekfinalistet e parë në Ligën e Kampionëve

LONDËR, 6 MARS - Bosurssia Dortmundi udhëton drejt "Stamford Bridge" me një epërsi minimale prej një goli dhe shpreson të ruajë atë dhe ta arrijë kualifikimin në çerekfinale të Ligës së Kampionëve. Dortmundi javë më parë e mposhti në "Westfalenstadion" Chelsean (1-0), kurse i duhet shumë

punë për ta përfunduar punën me gjigantet anglezë që assesi nuk do të pajtohen që të eliminohet kaq herët nga gara më e fortë e futbollit në botë. Trajneri Graham Potter rrezikon të shkarkohet, ani pse skuadra e tij fitoi në fundjavë në Premierë Ligë ndaj Leeds Unitedit (1-0).



Chelseat për këtë ndeshje i mungojnë Armando Broja, Edouard Mendy, Cesar Azpilicueta dhe Thiago Silva, ndërsa gjermanët do të jenë pa Julian Ryerson, Adeyemi, Youssoufa Moukoko, Mateu Morey, Abdoulaye Kamara, Donyell Malen dhe Julien Duranville. Sonte

**TË MARTËN TAKOHEN:**  
21:00 Benfica - Club Brugge  
21:00 Chelsea - B.Dortmund

zhvillohet edhe ndeshja tjetër në mes të Benficës dhe Club Brugge. Portugezët janë afër kualifikimit pas e fituan lojën e parë 0-2 dhe tash luajnë para shikuesve të vet.

## Sot dhe nesër zhvillohet java e fundit në Ligën Unike të Femrave



PRISHTINË, 6 MARS - Në mesjavë zhvillohet xhiroja e dhjetë në Ligën Unike të Femrave apo e fundit për garat e rregullta, ku do të caktohet renditja përfundimtare dhe skuadrat që do të hyjnë në "play-off". Final 4 i Ligës Unike të Femrave do të zhvillohet në Vlorë më 15-16 mars. Takimi i parë i kësaj xhiroje është ndërmjet Penzës dhe Prishtinës. Këto dy skuadra u përballën edhe të premtën në Superligën e Femrave në Kosovë, ku fituan vashat prishtinase 62:80. Në ndeshjen

e parë të këtij edicioni mes këtyre dy skuadrave prishtinaset kishin triumfuar bindshëm 91:68. Pejanet kanë dy fitore e shtatë humbje në Ligën Unike, kurse kryeqytetaset e Kosovës kanë pesë fitore e katër humbje. Të mërkurën do të zhvillohen dy takimet e tjera. Bashkimi do të ndeshet me Tiranën. Prizrenaset kanë gjashtë fitore e tri humbje, ndërsa tiranaset tri fitore e gjashtë humbje. Dueli i fundit zhvillohet në mes të Partizanit dhe Flamurtarit. Skuadra tiranase është në

**LIGA UNIKE E FEMRAVE - JAVA 10**

**Të martën takohen:**  
17:00 Penza - Prishtina

**Të mërkurën takohen:**  
17:00 Bashkimi - Tirana  
17:00 Flamurtari - Partizani

vendin e katërt me katër fitore e pesë humbje, ndërsa ajo vlonjate ka siguruar vendin e parë me shtatë fitore e dy humbje.

## Nazmi Gripshi, 'Ylli i javës' në Superligë

Prishtinë, 6 mars - Futbollisti i Ballkanit, Nazmi Gripshi, e ka fituar çmimin "Ylli i javës" për javën e 23-të në Superligë, të cilin e japin Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall. Gripshi, përveç që bëri

dallimin në fushë, shënoi një supergol për skuadrën e tij, i cili i motivoi portokallezintë për t'u kthyer në rezultat dhe për të marrë një pikë të rëndësishme në këtë ballafaqim (2-2). "Është nder dhe kënaqësi që të shpallësh më i

miri xhiros në Albi Mall Superligë. Ky edicion i Superligës është shumë i luftuar dhe ka ndeshje shumë të vështira. Ballkani ndeshjet i merr një nga një dhe besoj që sado që rruga për ta mbrojtur titullin kampion është e

vështirë, ne do t'ia dalim. Një falënderim shkon për të gjithë bashkëlojtarët të cilët kontribuojnë çdoherë që performanca ime të jetë e mirë", ka theksuar Gripshi për faqen zyrtare të FFK-së.



## Kaela Hilaire, MVP e javës në Superligë

PRISHTINË, 6 MARS - Prishtina ka arritur të triumfojnë në derbin e xhiros së 19 të Superligës së Femrave, duke mposhtur Penzën me rezultat 62:80. Kësaj fitore të Prishtinës më së shumti i kontribuoi ish-lojtarja e Penzës, Kaela Hilaire, me 23

pikë, shtatë kërcime dhe gjashtë asistime. Ajo u shpall MVP e javës, që është hera e parë për të në këtë edicion. Hilaire u ndihmua nga bashkëlojtarja e saj Sarah Mgbeike, e cila shënoi 16 pikë, shtatë kërcime dhe pesë asistime. Në anën tjetër

Bashkimi triumfoi ndaj Trepçës me rezultat 83:69, ku kapitenia Aulona Muhadri ishte më e mira te vajzat nga Prizreni me 12 pikë, 14 kërcime dhe një asistim, kurse kapitenia u ndihmua edhe nga Dasia Evans e cila shtoi 22 pikë,

shtatë kërcime dhe dy asistime. Vëllaznimi regjistroi fitoren e dytë këtë edicion duke mposhtur United Basketball me shifrat 36:44. Më e mira e vajzave nga Gjakova ishte Tianna Sullivan me 14 pikë, 12 kërcime dhe dy asistime.



## Sukses historik, Tuhina kampione e turneut PAC-12

PRISHTINË, 6 MARS - Një sukses historik për ekipin e Washington State Cougars dhe basketbollisten Astera Tuhina, që është shpallur kampion i turneut PAC-12, duke mposhtur UCLA me rezultat 65:61 të dielën në Las Vegas. Skuadra e Washington ishte numër 7 dhe është bërë skuadra me nivelet më të ulëta që përparoi dhe fitoi titullin e PAC-12. Ky ishte një sukses historik, pasi është ekipi i parë sportiv i garave të Shtetit të Uashingtonit që kurorëzohet me titullin PAC-12. Meshkujt e kishin fituar para 80 vjetësh. Cougars do të kërkojnë ta sigurojnë fitoren e parë të programit në turneun NCAA më vonë këtë muaj. Astera Tuhina ka luajtur rol kyç në triumfin e ekipit të saj në debutimin e saj në këtë ligë. Tuhina në finale ka luajtur për 31 minuta, duke realizuar gjashtë pikë, gjashtë asistime dhe tri



kërcime, duke marrë vlerësime shumë pozitive për paraqitjen në finale, por edhe gjatë gjithë këtij edicioni. Fjalë shumë të mira kishte edhe trajnerja e saj. "Ajo në të vërtetë nuk është 'studente' e re. Ne e dinim që ditën e parë kur na është bashkuar ajo. Astera është larguar nga shtëpia në moshën 14-vjeçare për të luajtur në Spanjë. Është një lloj fëmije e

veçantë. Ka inteligjencë të lartë. Jam krenare dhe e lumtur për paraqitjen e saj. Tezja e saj që jeton në ShBA erdhi dhe e befasoi këtë mëngjes", ka thënë Ethridge. Astera është një nga basketbollistet më të talentuara të Kosovës. Ka luajtur për Kosovën A dhe grupmoshat e reja. Tuhina është shpresa e Kosovës.

## Phoenixi fiton sfidën e pretendentëve ndaj Dallasit, Lakersat mposhtin kampionët

DALLAS, 6 MARS - Sfida interesante të luajtura në NBA. Skuadra e Phoenixit fitoi me rezultat 130-126 ndaj Dallasit, dy ekipe pretendente për titull këtë sezon. Duranti me 37 pikë e Bookerit me 36 fituan duelin ndaj dyshes Donqiq - Irving, që së bashku realizuan 34 pikë. Zhgënjën Bostonin, që pësoi humbje si vendas nga New York (131-129) pas kohës shtesë (Quickley 38



pikë më i miri për nju-jorkezët). Skuadra e lakersave mundi me rezultat 113-105 kampionët e Golden States, në një ndeshje ku të gjithë titullarët e ekipit vendës realizuan mbi 10 pikë. Më i miri në fushë ishte Anthony Davis, autor i 39 pikëve. Pa probleme fitoi Houstonin, që falë 31 pikëve të Green mundi me rezultat 142-110 San Antonion. Milwaukee vijon të jetë lider në Konferencën

e Lindjes, duke fituar me rezultat 117-111 në fushën e Washingtonit. Antetokounmpo realizoi një "triple double", me 23 pikë, 10 rebounde e 13 asistime. Ekipi i Brooklynit mposhti me rezultat 102-86 Charlotten, ndeshje ku u dallua Bridges, autor i 33 pikëve. Oklahoma mposhti me rezultat 129-119 Utah Jazzin, ndeshje ku dallimin e bëri Alexander Shai me 38 pikë.

### Rezultatet

Dallas - Phoenix	126-130
Chicago - Indiana	122-125
Lakers - Golden State	113-105
Brooklyn - Charlotte	102-86
Orlando - Portland	119-122
Houston - San Antonio	142-110
Oklahoma - Utah Jazz	129-119
Boston - New York	129-131
Washington - Milwaukee	111-117
Clippers - Memphis	135-129

## Marquinho luan ndaj Bayernit

PSG-ja ka marrë lajme të mira para ndeshjes me Bayern Munchenin. Mbrojtësi brazilian Marquinhos do të jetë në dispozicion të trajnerit Galtier për ndeshjen e kthimit

të Ligës së Kampionëve ndaj Bayernit, që luhet të mërkurën në Gjermani. Lajmin e konfirmoi e përditshmjja franceze "L'Equipe". Braziliiani ka pasur një

problem fizik me muskujt e kofshës së djathtë. Lojtari nuk do të jetë në 100 % të formës, por trajneri do ta hedhë në fushën e lojës në këtë sfidë delikate për

sezonin e francezëve. Bayerni fitoi 1-0 në Francë ndeshjen e parë ndaj PSG-së, ndaj trajneri Galiter ka nevojë për të gjithë lojtarët titullarë për ta tentuar

përmbysjen e kualifikimin. Marquinhos do të luajë duke shtrënguar dhëmbët për ta ndihmuar ekipin, pasi prania e tij është e rëndësishme për PSG-në.

### SHKURT

#### Ancelotti: Do të luftojmë deri në fund për titullin

Real Madridi nuk ka arritur më shumë se një barazim pa gola 0-0 në udhëtim te Real Betisi. "Los Blancos" ka mbetur nëntë pikë mbraja lideres, Barcelonës, në tabelë dhe mbrojtja e titullit bëhet edhe më e vështirë. Por përkundër diferencës, trajneri i Real Madridit, Carlo Ancelotti, ka thënë se nuk dorëzohen për titullin dhe se do të luftojnë deri në fund për ta mbrojtur atë. "Mendoj se kjo ndaj Betisit ishte një ndeshje e hapur deri në fund, por në disa momente na mungoi efikasiteti. Kishim disa raste që mund të kishim shënuar. Për fat të mirë, u treguam të zotë sa i takon aspektit defensiv dhe, për mendimin tim, kampionati ende nuk mund të konsiderohet i mbyllur", ka thënë Ancelotti. "Sigurisht, avantazhi që ka Barcelona është shumë i vlefshëm për të, por kemi detyrën të luftojmë deri në fund. Ka edhe shumë ndeshje për t'u luajtur, por e kemi të qartë se duhet të luajmë më mirë në sfidat e mbetura", ka shtuar Ancelotti.

#### Salah, golashënuesi më i mirë në Premierligë në histori të Liverpoolit

Mohamed Salah ka bërë historinë me Liverpoolin. "Të Kuqtë" triumfuan këtë të diel në derbin ndaj Manchester Unitedit me rezultatin e thellë 7-0. Salah ishte një prej më të mirëve në fushë për vendasit. Ai ia doli të shënonte dy gola, teksa regjistroi edhe dy asistime. Me golat e shënuara në këtë përballje, sulmuesi egjiptian është bërë golashënuesi më i mirë në histori të Liverpoolit në Premierligë. 30-vjeçari tani numëron 129 gola me fanellën e skuadrës nga "Anfield" në elitën e futbollit anglez. Salah theu rekordin e Robbie Fowler, i cili kishte shënuar 128 gola.

#### Barça e dëshiron Thuramin

Djali i futbollistit legjendar Lilian Thuram, Marcus Thuram, po bën bujë në Evropë dhe të gjithë e duan atë. Sulmuesi i Borussia Monchengladbach është kthyer në një nga objektivat e skuadrës së Barcelonës për ta përforcuar mesfushën ofensive pasi bëri një paraqitje të shkëlqyer në Botërorin Katar 2022 dhe një sezon të mirë me ekipin gjerman. Kontrata e futbollistit 25-vjeçar përfundon më 30 qershor dhe klubi i tij aktual i Bundesligës tashmë është pajtuar me largimin e lojtarit pas përfundimit të kontratës. Nënshkrimi i tij do të bëjë që nga Barcelona të largohet Ansu Fati ose Ferran Torres.

#### Allegri, pas humbjes nga Roma: Po bëjmë gjëra të mëdha

Juventusit ka pësuar humbje nga Roma (1-0), por trajneri i "Zonjës së Vjetër", Massimiliano Allegri, ka thënë se lojtarët po bëjnë gjëra fantastike. "Djemtë duhet të jenë të qetë, ne kemi bërë 50 pikë deri më tani. Sigurisht kjo ishte një ndeshje që mund të na afronte me Atalantan dhe të qëndronim 9 pikë larg Romës, por ky është futbollit. E vërteta është që djemtë po bëjnë gjëra fantastike", ka thënë Allegri.

**DREJTORIA E SHMLM "LUCIANO MOTRONI" NË PRIZREN**

Nr. i prot:275

Mbështetur në nenin 11, të Udhëzimit Administrativ-Aktivitetet jashtëkurrikulare Nr.02/2016 dhe në vendimin nr.prot: 274 të datës: 02.03.2023, të KDSH-së SHMLM "Luciano Motroni" në Prizren, shpall:

**FTESË PËR OFERTË****Për ekskursion të maturantëve të SHMLM "Luciano Motroni" në Prizren**

Ftojme ofertuesit e kualifikuar (Agjensionet turistike organizatore të udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarf të mbyllur, për ekskursionin e maturantëve të Shmlm "Luciano Motroni" nga Prizreni për në Rpublikën e Shqipërisë me datë 15.05.2023 deri më 19.05.2023

Paraqitësit në tender duhet t'i plotësojnë këto kriteret:

- 1.Certifikatën e biznesit me informatë për biznesin.
- 2.Vërtetimin për pagesën e taksave komunale për vitin 2022 ne origjinale.
- 3.Vërtetimin e Administrates tatimore që nuk ka borgje për vitin 2022 ne origjinale.
- 4.Licencen e transportit nderkombëtar "D"
- 5.Referencat rreth organizimit te ekskursioneve me maturantë për tri vitet e fundit: 2020,2021,2022.
- 6.Fotokopjet e librezave te autobusëve që janë të regjistruar sipas procedurave ligjore dhe kontrolli Teknik.
- 7.Kopjen e sigurimit te autobuseve, patentë shoferë të vozitësve dhe licencat CPC të vozitësve.
- 8.Autobusët të jenë komfor me klimë dhe në numër te mjaftueshëm për mbi 450 vende.
- 9.Certifikatat mjekësore për vozitësit.
- 10.Kompania te sigurojë mjekun(Certifikate pune dhe diplome te mjekut)
- 11.Dëshmi për Hotelin e ofruar në Durrës
- 12.Të prezantohet ambienti(Komoditeti) së paku me foto i Hotelit, nr. i tel. te pronarit dhe adresa.
- 13.Hoteli të posedoj mbi 450 shtretër.
- 14.Sistemimi i nxënësve ne dhoma te jetë jo me shumë se 4 nxënës.
- 15.Të prezantohet menyja e ushqimit dhe pijeve për tri racione ditore për 5 ditë qëndrimi.
- 16.Të prezantoj Licencën e agjensionit të akreditimeve ushqimore ne vendqëndrimin e nxënësve.
- 17.Gjatë vizitave nëpër monumente të sigurohet shujta dhe pagesa e hyrjes sipas itinerarit te përcaktuar nga KDSH-ja
- 18.Hoteli te posedoj sallë për argëtim për nxënës dhe të mos shërbehen dhe lejohen pijet alkoolike.
- 19.Oferta për nxënës të liruar nga pagesa.
20. Agjensioni të ofrojë dëshmi për qarkullimin financiar nga banka për tri vitet e fundit se paku 200.000 euro.

**Verejtje:** Kompania turistike fituese në përfundim të ekskursionit duhet të siguroj nënshkrimet nga: Drejtori i shkolles, Kryetari i KDSH-se, kryetares se Këshillit të nxënësve, për përmbushjen e kushteve te përcaktuara sipas kriterëve te lartëcekura dhe ky dokument të dorëzohet në DKA.

Ofertuesit e interesuar aplikacionin dhe itinerarin e udhëtimit mundë ti marrin në administratën e shkollës dhe të kompletuara me dokumentacionin e kërkuar të dorëzohen në Drejtorinë e Arsimit ne Prizren.

Afati i paraqitjes në Tender është 7 ditë pune, nga dita e publikimit në gazetë.

Hapja e ofertave bëhet nga Komisioni sipas UA 02/2016 me datën: 16.03.2023 në ora16:00 Prizren ku mundë të marrin pjesë edhe ofertuesit.

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i paraparë sipas UA do të verifikoj dokumentacionin dhe kushtet e ofruara nga Kompanitë, ku do te bëhet vlerësimi i tyre. Përparësi në shqyrtimin e ofertave nga ana e komisionit do të kenë Agjensionet turistike që i kanë të kompletuar ofertat, kanë numër të mjaftueshëm autobusësh.

Fituesi i ofertës për organizimin e ekskursionit do të jetë kompania turistike e përgjegjësme me çmimin më të ulët te ofertës. Drejtorja e shkollës mban të drejtën për anulimin e ofertës.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

**RESTAURANT****SWISS TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- N.SH. Studio Grafike Convert, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 600317839.

- Besnik Gashi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shm Teknike "Nexhmedin Nixha" Elektro Teknik Gjakovë.

- Denis Demjana nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të shm Ekonomike "Kadri Kusari".

- Egon Koci nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10.11.12. dhe diplomën e shme "Kadri Kusari" Gjakovë.

- N.T.SH. "Ana" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr Unik. 811526724 nrb. 600307228.

- Enis Xhafa shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme "Arkitekt Sinani"

- Emir Xhafa shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme "Arkitekt Sinani".

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



## PASHTETË PULE

MEKA  
HALAL FOOD

gluten  
free



cilësi e garantuar

pa konservues